




Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>DPK</u>	03-02/474/16
Dep.	Prot. No.
Nr. lfaq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date
	04.11.2016
	PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.11.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3393/16, për zyrtarin e lartë z. Burim Susuri, Sekretar i Parë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mospajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3393/16, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Burim Susuri, Sekretar i Parë në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mospajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë, Burim Susuri, Sekretar i Parë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, figuron si person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mospajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Burim Susuri ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është njoftuar me çështjen e iniciuar për konflikt të interesit.

z. Susuri gjatë këtij komunikimi është pajtuar me faktet e prezantuara dhe është deklaruar se nuk ka pasur njohuri lidhur me çështjen konflikt të interesit, por ka theksuar se për biznesin te cilin behet fjalë ka filluar procedurat për shuarjen e tij pasi qe nuk zhvillon aktivitet dhe është zotuar se brenda afatit ligjor do te sjell dëshminë qe biznesi është shuar.

Me datën 31.10.2016 nga z. Burim Susuri, kemi pranuar dokumentet zyrtare të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se biznesi me emër Agjencioni Për Menagjim Profesional "Dua, është shuar ne mënyrë vullnetare.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Burim Susuri, Sekretar i Parë në Ministrin e Punëve të Jashtme, janë krijuar rrethana të reja dhe konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mospajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

